



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 6674 Prot.

Lezhë, më 27/10 /2025

URDHËR
Nr. 265., datë 27/10 /2025

“PËR

KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE PËR HAPJEN
E THIRRJES SË VII-TË TË PROGRAMIT RELOAD TË FINANCUAR NGA BASHKIA
LEZHË”

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimi Nr. 393., datë 18.07.2022 Për “Miratimin e rregullores “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë, ” Vendim të Këshillit Bashkiak Lezhë Nr. 211., datë 31.10.2017 “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë si dhe miratimin e metodologjisë për alokimin e fondeve për Organizatat e Shoqërisë Civile (LOD)” pika 2. “Të miratohet Metodologjia LOD për alokimin e fondeve për Organizatat e Shoqërisë Civile, të propozuar nga UNDP dhe të miratuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë” si dhe Vendim i Këshillit Bashkiak Lezhë Nr. 99., datë 19.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2025”.,

URDHËROJ:

1. Krijimin e grupit të punës për kryerjen e procedurave për Hapjen e Thirrjes së VII-të të programit ReLOaD, i cili është i financuar nga buxheti i Bashkisë Lezhë, si më poshtë:

- **Brikena Vuksani** – Kryetar, me detyrë Zv. Kryetar në Bashkinë Lezhë;
- **Vasilika Laska** – Koordinator, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës;
- **Mariolina Lleshi** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit;
- **Altin Lleshi** - Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike;
- **Jetmira Leka** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;



- **Keler Sufja** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit;
 - **Renaldo Xhanej** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Turizmit;
 - **Marte Fetaj** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social;
 - **Mimoza Xhafa** – Anëtar, me detyrë Drejtor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve;
 - **Paulin Gjergji** - Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve;
 - **Jona Dividi** - Anëtar, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore.
2. Grupi i punës do të angazhohet për përcaktimin e prioriteteve në përputhje me dokumentat strategjik të Bashkisë Lezhë në konsultimin publik me Organizatat e Shoqërisë Civile, si dhe për përcaktimin dokumentave dhe paketës për hapjen e Thirrjes së 7-të.
 3. Koordinator i grupit do të koordinojë informacionin brenda grupit të punës dhe të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen të ofrojnë informacionin sipas fushave që mbulojnë.
 4. Grupi i punës të angazhohet për përgatitjen dhe shpalljen e Thirrjes së 7-së Publike.
 5. Kohëzgjatja e punës së grupit do të jetë gjatë gjithë kohëzgjatjes së thirrjes në fjalë.
 6. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet grupi i punës.
 7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Pjëriri NDREU

